

Racizmi dhe diskriminimi

Ç'është racizmi dhe diskriminimi ?

Çfarë thotë ligji në lidhje me racizmin?

Jeni viktimë ose dëshmitar i racizmit? Ç'duhet të bëni?

Doni të angazhoheni kundër racizmit?

Ç'është racizmi dhe diskriminimi ?

Kemi të bëjmë me racizëm kur njerëzit mendojnë se një grup individësh është më i mirë, ose më pak i mirë, se të tjerët, për shkak të pamjes së tyre fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës ose fesë së tyre. Racizmi shfaqet në jetën e përditshme (punë, strehim, fqinjësi, etj.). Ai shprehet në forma të ndryshme (fjalë lënduese, fyerje, sulme, përjashtime, etj.). Racizmi është i ngulitur në shoqërinë dhe institucionet tona. Ai është i lidhur me historinë tonë shumëshekullore.

Ç'është racizmi?

Kemi të bëjmë me racizëm kur njerëzit mendojnë se një grup individësh është më i mirë, ose më pak i mirë, se të tjerët, për shkak të paraqitjes së tyre fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës ose fesë së tyre.

Racizmi është çështje pushteti. Ai përdoret për të dobësuar disa grupe individësh dhe forcuar disa të tjerë.

Racizmi është i pranishëm në shumë fusha të jetës së përditshme, si puna, kërkimi i një banese ose marrëdhëniet me fqinjët.

Racizmi mund të marrë forma të ndryshme: fyerje, sulme dhe përjashtime.

Racizmi nuk është gjithmonë i qëllimshëm ose i ndërgjegjshëm. Ai është i ngulitur në shoqërinë tonë, në institucionet dhe zakonet tona shoqërore. Për shembull, racizmi kundër njerëzve me ngjyrë vjen nga historia jonë me kolonializmin dhe skllavërinë.

Diskriminimi

Kemi të bëjmë me diskriminim është kur e trajtojmë një individ ose një grup individësh në mënyrë të padrejtë, për shkak të paraqitjes fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës, fesë, gjinisë, orientimit seksual ose aftësisë së kufizuar.

Kemi të bëjmë me diskriminim racor kur e dëmtojmë dikë, për shkak të paraqitjes së tij fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës ose fesë së tij.

Format e ndryshme të racizmit

- Racizmi ndër-personal (ose racizmi midis individëve): janë paragjykime ose një qëndrim i mbyllur dhe agresiv kundrejt individëve të tjerë për shkak të origjinës ose pamjes së tyre fizike (ngjyrës së lëkurës). Ai mund të shprehet me fjalë lënduese, fyerje, diskriminime ose dhunë.
- Racizmi kulturor: disa kultura nënçmohen ose nuk respektohen, për shkak të stereotipeve raciste. Një stereotip është kur mendojmë “të gjithë afrikanët ose të gjithë aziatikët janë ...”. Stereotipet mund të përforcohen në filma, në art ose në përfaqësime kulturore.
- Racizmi strukturor (ose racizmi në struktura): është kur racizmi dhe pabarazitë janë të pranishme në rregullat dhe organizimin e një shoqërie.

Shumë shpesh, kjo çon në diskriminime, edhe pse askush nuk e do në mënyrë të drejtpërdrejtë.

- Racizmi institucional (ose racizmi në institucione): është kur pabarazitë dhe diskriminimet janë të pranishme në institucione të rëndësishme të shoqërisë, si shkollat ose bota e punës. Racizmi institucional nuk është gjithmonë i dukshëm. Ai është i fshehur. Nga jashtë, nuk shihet asgjë, gjithçka duket normale.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/racizmi-dhe-diskriminimi/ceshte-racizmi-dhe-diskriminimi

Çfarë thotë ligji në lidhje me racizmin?

Zvicra nuk ka ndonjë ligj të posaçëm kundër racizmit dhe diskriminimit. Megjithatë, në Kushtetutën e saj dhe në të drejtën penale, Zvicra e ndalon diskriminimin. Në të drejtën private (kodin civil) ka disa nene që mbrojnë kundër racizmit dhe diskriminimeve.

Përdorimi i termit “racë”

Termi “racë” përdoret shpesh në ligj. Për këtë arsye, edhe ne e përdorim termin “racë”, megjithëse, në realitet, racat njerëzore nuk ekzistojnë. Qeniet njerëzore i përkasin të gjitha një lloji të vetëm.

Por në mendësitë dhe në mendjen e njerëzve, ideja e “racave” ekziston ende.

Është një ndërtim shoqëror. Diskriminimi racor bazohet në këtë ide:

njerëzit nuk janë të barabartë me njëri-tjetrin, për shkak të “racës” së tyre. Edhe pse racat njerëzore nuk ekzistojnë.

Kushtetuta federale

Kushtetuta federale është ligji zviceran më i rëndësishëm. Kushtetuta federale përcakton rregullat kryesore të shtetit. Ajo garanton gjithashtu të drejtat themelore të individëve përballë Zvicrës dhe autoriteteve të saj.

Ajo që është shkruar në Kushtetutë (rregullat kryesore dhe liritë) nuk ka të bëjë me marrëdhëniet e individëve midis tyre. Ka të bëjë vetëm me marrëdhëniet e individëve me shtetin. Kushtetuta mbron individët ndaj abuzimeve ose padrejtësive të shtetit. Kushtetuta federale (Kusht.) thotë: të gjithë individët janë të barabartë para ligjit (neni 8 paragrafi 1).

Paragrafi 2 i të njëjtit nen saktëson: askush nuk duhet të jetë viktimë e diskriminimit për shkak, për shembull, të origjinës së tij, “racës”, gjuhës, mënyrës së tij të jetesës ose bindjeve të tij fetare.

Kodi penal dhe neni i tij 261bis

Kodi penal është një rregullore federale .

Ai përcakton aktet që janë të papranueshme në shoqërinë tonë. Ai parashikon ndëshkime për këto akte.

Të nxitësh njerëzit e tjerë për urrejtje dhe diskriminim është e papranueshme.

Kjo ndalohet nga Kodi penal (KP). Ai dënon:

- individët që i nxisin të tjerët për urrejtje ose diskriminim kundrejt një individi ose një grupi individësh për shkak të pamjes së tyre fizike (ngjyrës së lëkurës), të origjinës, fesë ose orientimit seksual të tyre
- individët që shprehin, në mënyrë publike, ide raciste ndaj një individi ose një grupi individësh
- individët që përçmojnë ose diskriminojnë, në mënyrë publike, një individ ose një grup individësh, për shkak të pamjes së tyre fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës, fesë ose orientimit seksual të tyre
- individët që thonë në mënyrë publike se gjenocidi (shfarosja e disa popujve) nuk ka ekzistuar ose nuk është diçka shumë e rëndë.
- individët që refuzojnë t'u ofrojnë shërbime ose mallra një individi ose një grupi individësh, për shkak të pamjes së tyre fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës, fesë ose orientimit seksual të tyre. Ndërkohë që këto shërbime dhe këto mallra janë për të gjithë.

Këto akte janë të ndaluara vetëm nëse kryhen në mënyrë publike. Kjo do të thotë se vetëm nëse individët e pranishëm nuk njihen mirë mes tyre.

Për të dënuar akte të tilla, ndëshkimi mund të jetë me gjobë (para) ose ndonjëherë me burg maksimumi 3 vjet.

Ç'duhet bërë, nëse jeni viktimë ose dëshmitar i racizmit?

Çdo individ, viktimë ose dëshmitar i këtyre akteve, të ndaluara me ligj, mund t'ia sinjalizojë komisariatit më të afërt të policisë. Ai mundet gjithashtu t'ia njoftojë me shkrim prokurorisë ose gjykatësit hetues.

Më pas, autoritetet verifikojnë faktet. Nëse veprat kanë të bëjnë me nenin 261bis të Kodit penal, drejtësia i ndjek drejtpërdrejt autorët e këtyre akteve (ndjekje gjyqësore kryesisht).

Kodi civil

Kodi civil përcakton rregullat e marrëdhënieve ndërmjet individëve. Ai përcakton të drejtat dhe detyrimet e secilit.

Për shembull, Kodi civil rregullon marrëdhëniet familjare, trashëgimitë dhe kontratat e ndryshme: kontratat e punës, të shitjes, të qirasë dhe të ofrimit të shërbimeve.

Kodi civil siguron mbrojtjen e personalitetit (neni 28 i kodit civil KC dhe neni 328 i kodit të detyrimeve KD).

Ç'është mbrojtja e personalitetit?

Për Kodin civil, mbrojtja e personalitetit është, për shembull: mbrojtja e jetës së individit, respektimi i trupit të tij, mbretja e nderit dhe jetës së tij private dhe elementeve të tjera të rëndësishme për personalitetin.

Një individ i është cenuar personaliteti nga një akt racist? Ai ka të drejtë ta denoncojë autorin e këtij akti para drejtësisë. Ky individ mundet të kërkojë edhe dëmshpërblim.

Një konventë ndërkombëtare kundër diskriminimeve racore

Si vende të tjera, Zvicra ka nënshkruar "Konventën ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor". Duke e nënshkruar, shtetet angazhohen të eliminojnë të gjitha format e diskriminimit racor në vendet e tyre.

Ata angazhohen gjithashtu të nxisin mirëkuptimin midis grupeve të individëve dhe midis "racave".

Termi "racë" përdoret shpesh në ligj. Për këtë arsye, edhe ne e përdorim termin "racë", megjithëse, në realitet, racat njerëzore nuk ekzistojnë. Qeniet njerëzore i përkasin të gjitha një lloji të vetëm.

Por në mendësitë dhe në mendjen e njerëzve, ideja e "racave" ekziston ende.

Është një ndërtim shoqëror. Diskriminimi racor bazohet në këtë ide:

njerëzit nuk janë të barabartë me njëri-tjetrin, për shkak të "racës" së tyre. Edhe pse racat njerëzore nuk ekzistojnë.

Shtetet që e kanë nënshkruar këtë Konventë duhet të hartojnë rregullisht raporte. Ata duhet t'i paraqesin Komitetit për eliminimin e diskriminimit racor masat që kanë ndërmarrë për të zhdukur diskriminimin racor në vendin e tyre.

Zvicra e ka nënshkruar Konventën. Edhe ajo duhet t'i hartojë këto raporte.

Kur një individ apo grup individësh është viktimë e racizmit dhe kur këta individë i kanë përdorur të gjitha mjetet e ankimit në Zvicër, pa sukses, ata mund t'i drejtohen Komitetit për eliminimin e diskriminimit racor.

Komiteti ia përcjell më pas situatën vendit në fjalë, pa e përmendur emrin e individit.

Më pas Komiteti i dërgon vendit dhe individit të interesuar një vendim me rekomandime dhe propozime. Kjo sensibilizon vendin dhe njerëzit mbi realitetin e racizmit. Vendi i interesuar nuk është i detyruar t'i ndjekë këto rekomandime. Por gjykatat i përdorin këto rekomandime për të dhënë vendime juridike.

Vendimet e gjykatave si shembuj

Është e rëndësishme të njihen dhe të mblidhen vendimet e gjykatave në lidhje me diskriminimet. Kjo shërben si shembull për situata të reja. Quhet jurisprudencë. Në Zvicër, Komisioni federal kundër racizmit regjistron në faqen e tij vendimet e gjykatave.

Info-racizëm i Caritas Suisse paraqet gjithashtu vendimet e gjykatave. Ai bën përmbledhje dhe i klasifikon në kategori, si bota e punës, rrjetet sociale dhe mediat, shkolla dhe feja.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/racizmi-dhe-diskriminimi/cfare-thote-ligji-ne-lidhje-me-racizmin

Jeni viktimë ose dëshmitar i racizmit? Ç'duhet të bëni?

Diskriminimi racor mund të ndodhë në të gjitha fushat e jetës: shkollë, punë, veprimtaritë argëtuese, etj. Bureau de l'intégration des étrangers et de la lutte contre le racisme (Zyra e integritetit të të huajve dhe e luftës kundër racizmit) i ofron dëgjim, informacione dhe këshilla çdo individ të prekur nga racizmi, si viktimë apo si dëshmitar.

Ç'duhet bërë nëse jeni viktimë ose dëshmitar i racizmit?

Diskriminimi racor mund të ndodhë në të gjitha fushat e jetës.

Bureau de l'intégration des étrangers et de la lutte contre le racisme (Zyra e integritetit të të huajve dhe e luftës kundër racizmit) i ofron dëgjim, informacione dhe këshilla çdo individ të prekur nga racizmi, si viktimë apo si dëshmitar.

Këshillimet janë falas dhe konfidenciale.

Këshillimet mund të marrin formë të ndryshme:

- me biseda ballë për ballë
- me telefon
- me e-mail

Mund të merrni takim me telefon në numrin 032 420 51 12:

Të hënën dhe të enjten nga ora 8:30 në orën 12:00 dhe nga ora 13:30 në orën 16:30

Të premten nga ora 8:30 në orën 12:00 dhe nga ora 13:30 në orën 16:00

ose me e-mail në secr.bi@jura.ch.

Bureau de l'intégration des étrangers et de la lutte contre le racisme (Zyra e integritetit të të huajve dhe e luftës kundër racizmit)

mban shënim dhe regjistron çdo rast diskriminimi në kantonin e Jura-së.

Rastet mbeten anonime, emrat e njerëzve nuk shkruhen.

Doni të paraqisni një situatë diskriminimi?

Në të gjitha rastet, paraqisni sa më shumë informacione dhe dokumente që të jetë e mundur.

Për shembull: mbani shënime (cili, çfarë, vendi, data), bëni fotografi, ruajini mesazhet dhe videot.

Doni të bëni padi? Të gjitha këto prova mund të jenë të dobishme për vijimin e çështjes.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/racizmi-dhe-diskriminimi/jeni-viktime-ose-deshmitar-i-racizmit-cduhet-te-beni

Doni të angazhoheni kundër racizmit?

Ka mënyra të ndryshme për të luftuar kundër racizmit: të informoheni, të flisni rrotull jush për këtë temë, të denonconi aktet raciste, të mbështesni viktimat dhe të angazhoheni në projekte. Bureau de l'intégration des étrangers et de la lutte contre le racisme (Zyra e integritetit të të huajve dhe e luftës kundër racizmit) këshillon dhe mbështet individët që dëshirojnë të angazhohen.

Keni një projekt?

Dëshironi të angazhoheni në luftën kundër racizmit, me veprime parandalimi ose ndërgjegjësimi? Keni një projekt për të luftuar kundër diskriminimit dhe për të vepruar për "Të jetuar së bashku"?

Bureau de l'intégration des étrangers et de la lutte contre le racisme (Zyra e integritetit të të huajve dhe e luftës kundër racizmit) këshillon dhe mbështet individët që duan të krijojnë projekte për të luftuar kundër racizmit.

Kjo Zyrë organizon çdo vit Javën e veprimit kundër racizmit (SACR).

Ju mundeni gjithashtu të propozoni një aksion për këtë Javë.

Në botën e punës

Dëshironi të ndërgjegjësoni ekipet tuaja profesionale ose të trajtoni personelin tuaj mbi çështjet e diskriminimit në punë? Dëshironi të ofroni një vend pune pa diskriminim?

Dëshironi të ofroni shërbime pa diskriminim?

Bureau de l'intégration des étrangers et de la lutte contre le racisme (Zyra e integritetit të të huajve dhe e luftës kundër racizmit) këshillon dhe mbështet administratën, institucionet, bizneset dhe shoqatat. Ajo i orienton për të organizuar trajnime mbi çështjet e racizmit dhe të diskriminimit.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/racizmi-dhe-diskriminimi/doni-te-angazhoheni-kunder-racizmit